



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:240539

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05392997

**C.nr.204/21**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarën Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, **në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. N. nga fsh..., Komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokateve “K. &ASS. L.L.C” nga Prishtina, Blv. Deshmoret e K. Ul. C-, 2/.. hyrja..., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komuna e Arsimit me seli në Dragash, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit përfaqësuesi Ramadan R. Krasniqi nga Dragashi, me objekt kontesti Kompenzimin e avancimit të karrier - Licencat, vlera e kontestit 4.866.21 Euro, jashtë seance me datën 29.02.2024, mori këtë:**

## A K T G J Y K I M

**I. HUDHËT POSHTË si e palejueshme padia** e paditësit S. N. nga fsh..., Komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokateve “K. &ASS. L.L.C” nga Prishtina, Blv. D. e K. Ul. C-..., 2/.. hyrja..., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson Isljam Rexheplar nga Dragashi, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, lidhur me kompensimin e avancimit ne karrier dhe zhvillim profesional, *për shkak të parashkrimit të kërkesës.*

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

## A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, më datë 21.10.2021, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Dragashit, me objekt kontesti kompensimit e avancimit ne karrierë dhe zhvillim profesional, në lartësi 27 % të pagës bazë edhe atë për periudhën 18.04.2017 – 22.01.2021. Përfaqësuesja e paditësit përmes parashtrësës së datës 24.11.2023 e ka bërë plotësimin dhe precizimin e padisë-kërkesëpadi ku ka kërkuar kompensimit e avancimit ne karrierë dhe zhvillim profesional, në lartësi 27 % të pagës bazë edhe atë për periudhën 18.04.2017 -21.11.2022 e me vlerë të përgjithshme monetare prej 4,866.21 €, duke theksuar se: Në padinë e dorezuar prane kesaj gjykate është theksuar se kërkesëpadia është e mbështetur në Kontraten Kolektive të Arsimit neni 7 paragrafi 1, pika 1.3, e nënshkruar me dt.18.04.2017 Udhëzimin Administrativ nr. 24/2014, nenin 21 si dhe nenit 90 të Ligiit Nr.03/L-212 të Punës, dispozitat e të cilave kanë paraparë zbatimin dhe obligimin e te paditurës lidhur me kërkesëpadinë e parashtruar nga paditësi në këtë gjykatë. Përpos Kontratës Kolektive Sektoriale per Arsim, Kërkesëpadia ka mbështetje ligjore dhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008, ashtu qe në pikën 3 të këtij vendimi percaktohet:

ngritja e pages për mësimdhënës, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm behet në bazë të kriterëve të licencimit, si përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës. Ndërsa në pikën 4.3 të Vendimit të cekur më lartë përcaktohet se: "Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pageses bazë prej 27%". Ndërsa në pikën 4.4 përcaktohet se: "Me diplomë të ciklit të dytë dhe tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pageses bazë prej 35% si dhe në Mendimin juridik me nr.prot.214/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ka theksuar se paditësi është i punësuar të e paditura, në cilësinë e mësimdhënësit, i njëjti është i licencuar dhe se ka bërë kërkesë tek e paditura për kompensim, por që kërkesa e paditësit është refuzuar, ka shtuar se e paditura, paditësit i ka paguar shumën prej 41.04 euro në muaj në emër të kompensimit e avansimit në karrierë dhe zhvillim profesional, në lartësi 27 % të pagës bazë, ashtu që diferenca e mbetur për një muaj është shuma 72.63 euro. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t'ia kompensojë paditësit shumën e lartëcekura edhe atë nga muaji prill 2017 deri më 14.05.2018. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë sipas tarifës OAK-së, për përpilimin e padisë në shuntë prej 104.00 Euro, taksën për padi 41.00 Euro dhe për përpilimin e kesaj parashtrës në shumën prej 104.00 Euro, gjithësej në shumën e përgjithshme prej 249,00 Euro.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësve.

Gjithashtu të paditurës i është dërguar dhe parashtrës e paditësit e datës 24.11.2023.

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 18.11.2023, ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se nuk gjen mbështetje ligjore, nuk prodhon efekt juridik për të paditurën, nga arsyeja se kontratës kolektive i ka kaluar afati duke u bazuar në ligjin e punës në bazë të së cilit afati i kontratës kolektive në zbatim është tri vjet, ashtu që gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke u thirrur dhe në parashkrim, Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Ndërkaq gjykata duke shqyrtuar padinë e paditësit sipas detyrës zyrtare dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ka vlerësuar se padia e paditësit është e vjetërsuar, po citojmë: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënja e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës". Në këtë drejtim nga shkresat e lëndës gjykata konstaton se nga kopja e leternjoftimit për paditësin provohet se i njëjti ka lindur me datë 12.06.1953, fakt ky që nënkupton se i njëjti me datë 12.06.2018 i ka mbushur edhe vitet e pensionimit e që nënkupton se edhe automatikisht i është ndërprerë marrëdhënja e punës. Kurse kërkesa respektivisht padia i është dorëzuar gjykatës me datë 21.10.2021 e që nënkupton katër (4) muaj pas kalimit të afatit prej 3 vitësh ashtu edhe siç është specifikuar me dispozitën e cituar më lartë.

Gjithashtu në bazë të nenit 391 pika f) të LPK-së është parashikuar: "Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se...f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj". Ndërsa me Ligjin e Punës neni 87 i tij në mënyrë taksative është përcaktuar afati prej tre (3) vitësh si afat për parashkrimin e kërkesave nga marrëdhënja e punës në para, e nga padia konstatohet se kjo kërkesë është kërkesë rreth pagesës monetare në lidhje me kualifikimin – licencimin dhe se e njëjta është parashtruar në gjykatës pas afatit të parashikuar me dispozita materiale respektivisht Ligjin e punës.

Andaj gjykata duke marrë parasysh argumentet e paraqitura më lartë, ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 391 pika f të LPK-së.

Gjykata vendosi që secila palë t'i kompenzon shpenzimet e veta, pasi palës paditëse i është hedhur padia, ndërsa pala e paditur nuk ka parashtruar kërkesë të specifikuar për njohjen e tyre. Përndryshe, vendimarrja në lidhje me këtë pikë bazohet në nenin 463 paragrafin 2 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:240539, 29.02.2024**

**G j y q t a r j a,**

---

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.